

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të PARASHTRUAR nga Volkswagen Aktiengesellschaft, shoqëri aksionare, me seli të regjistruar në Berliner Ring 2, 38440 Wolfsburg, Gjermani, dhe Nikolaus (BC) BidCo GmbH, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me seli të regjistruar në Eschersheimer Landstraße 50-54, c/o Apex Corporate Products (Gjermani), 60322 Frankfurt am Main, Gjermani, përmes Shoqërisë së Avokatëve Qoku DHE Partnerët nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë 17.08.2026, miratoi këtë:

AKTVENDIM

1.Konstatohet se përqendrimi me të cilin Volkswagen Aktiengesellschaft, shoqëri aksionare, me seli të regjistruar në Berliner Ring 2, 38440 Wolfsburg, Gjermani, dhe Nikolaus (BC) BidCo GmbH, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me seli të regjistruar në Eschersheimer Landstraße 50-54, c/o Apex Corporate Products (Gjermani), 60322 Frankfurt am Main, Gjermani, do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi shoqërinë Everlens SE, shoqëri evropiane (Societas Europaea), me seli të regjistruar në Stadtbachstraße 1, 86153 Augsburg, Gjermani, përmes shitblerjes së pjesëve, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë parandalimin, kufizimin ose shtrembërimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve, dhe **është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, në kuptim të nenit 19, paragrafi (1), pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2.Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin për përqendrim në vlerë prej 6.000 den. dhe për aktvendimin në vlerë prej 30.000 den., sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për Taksat Administrative (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 151/21) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, shifra e të hyrave dhe programi 72231300.

3.Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më datë 13.07.2026, ndërsa e plotësuar më datë 24.07.2026, pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) është dorëzuar njoftimi për përqendrim nga Volkswagen Aktiengesellschaft, shoqëri aksionare, me seli të regjistruar në Berliner Ring 2, 38440 Wolfsburg, Gjermani, dhe Nikolaus (BC) BidCo GmbH, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me seli të regjistruar në Eschersheimer Landstraße 50-54, c/o Apex Corporate Products (Gjermani), 60322 Frankfurt am Main, Gjermani, me të cilin Volkswagen Aktiengesellschaft dhe Nikolaus (BC) BidCo GmbH do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi

shoqërinë Everlens SE, shoqëri evropiane (Societas Europaea), me seli të regjistruar në Stadtbachstraße 1, 86153 Augsburg, Gjermani.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit që nga dita e pranimit të tij dhe, në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për përqendrim, plotësimin dhe shtojcat e tij, konstatoi si vijon:

Veprimtaritë kryesore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

Volkswagen Aktiengesellschaft është prodhues gjerman i automobilave dhe shoqëri udhëheqëse e Grupit Volkswagen („Grupi Volkswagen“).

Grupi Volkswagen është aktiv në nivel global, përfshirë në të gjitha shtetet anëtare të BE-së, kryesisht në zhvillimin, prodhimin, marketingun dhe shitjen e automobilave për udhëtarë, automjeteve të lehta komerciale, kamionëve, autobusëve, autobusëve turistikë, shasisë për autobusë dhe motorëve me naftë (dizel), si dhe motoçikletave, duke përfshirë për secilën prej tyre pjesët e këmbimit dhe aksesorët. Grupi Volkswagen është po ashtu aktiv në shpërndarjen e automjeteve. Grupi Volkswagen përfshin markat e automjeteve me motor: Volkswagen, Volkswagen Commercial Vehicles, Porsche, Audi, Škoda, Bentley, Lamborghini, SEAT, Cupra, MAN, Scania dhe Ducati.

Përveç kësaj, Grupi Volkswagen ofron gjithashtu shërbime financiare dhe shërbime sigurimi të lidhura me shpërndarjen dhe financimin e automobilave dhe automjeteve të veta komerciale, si dhe zgjidhje energjetike dhe zgjidhje për mbushjen e baterive për konsumatorët e vet, në kuadër të aktiviteteve të tij në fushën e elektromobilitetit.

Grupi Volkswagen është i pranishëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes shoqërive të varura të mëposhtme:

- Porsche Leasing SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në Bulevardin Bosnja dhe Hercegovina nr. 3, Shkup, me veprimtari primare 64.910 – Lizingu financiar;
- Porsche Broker AD Shkup, me seli të regjistruar në Bulevardin Bosnja dhe Hercegovina nr. 3, Shkup, me veprimtari primare 66.220 – Veprimtari të agjentëve dhe ndërmjetësve të sigurimeve;
- Scania Makedonija SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në rr. 34 nr. 7 Ilinden, Shkup, me veprimtari primare 46.710 – Tregti me shumicë e automjeteve me motor; dhe
- Porsche Makedonija SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në Bulevardin Bosnja dhe Hercegovina nr. 4, Shkup, me veprimtari primare 46.710 – Tregti me shumicë e automjeteve me motor, Shkup.

Veprimtaritë primare të këtyre shoqërive në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë kryesisht tregtia me automjete me motor dhe lizingu financiar.

Nikolaus (BC) BidCo GmbH është shoqëri me qëllim të posaçëm e themeluar për nevojat e Transaksionit të Propozuar dhe nuk ushtron veprimtari në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Nikolaus (BC) BidCo GmbH kontrollohet nga fonde me të cilat menaxhon dhe/ose të cilat i këshillon Bain Capital. Bain Capital është shoqëri private investuese me seli të regjistruar në Boston, SHBA, e cila investon në shoqëri nga disa sektorë industrialë, përfshirë teknologjinë e

informacionit, kujdesin shëndetësor, tregtinë me pakicë dhe produktet e konsumit të gjerë, komunikimet, shërbimet financiare, si dhe prodhimin industrial dhe industrinë përpunuese.

Everlens SE (emërtimi i mëparshëm: MAN Energy Solutions SE), me seli në Augsburg (Gjermani), është shoqëri inxhinierike që vepron në nivel global dhe është e specializuar për zgjidhje motorike/shtytëse dhe energjetike për sektorin detar, energjetik dhe industrial. Shoqëria zhvillon dhe prodhon motorë, turbomakineri dhe sisteme shtytëse, me fokus të veçantë në teknologjitë e dekarbonizimit dhe zgjidhjet për përmirësimin e efikasitetit energjetik. Po ashtu, Everlens SE ofron shërbime përgjatë gjithë ciklit të jetës së produkteve të veta, përfshirë mirëmbajtjen dhe optimizimin e performancës së tyre, përmes rrjetit të vet global të shërbimeve.

Në qershor të vitit 2025, MAN Energy Solutions SE ndryshoi zyrtarisht emërtimin e saj në Everlens SE. Everlens SE është shoqëri e varur indirekte në pronësi të plotë të Volkswagen Aktiengesellschaft dhe është pjesë e Grupit Volkswagen.

Everlens SE nuk ka shoqëri të varura të themeluara në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe nuk realizon asnjë lloj qarkullimi në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i paraqitur bie nën dispozitat e Ligjit, pasi i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafët (2), (3) dhe (4) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat, gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i paraqitur, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të njëjtin, pasi nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KRYETARE

Mr. Малинка Силјановска Николиќ